

Vendim nr. 58, datë 26.05.2026

(V- 58/26)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fiona Papajorgji, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Sonila Bejtja, anëtarë, me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 26.05.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 36 (A) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **AJLIN SHARKU,**
KENIN SHARKU, përfaqësuar nga Mimoza Vokshi, me prokurë të përgjithshme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

ALBERT HOXHA, KIMETE HOXHA

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-726, datë 19.02.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, pika 1, 17, 41, 42 dhe 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 27, 39, 49, 71, 71/a dhe 76, pika 6, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarve Ajlin Sharku dhe Kenin Sharku (*kërkuarët*), të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Albert Hoxha dhe Kimete Hoxha (*subjektet e interesuara*), që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesit janë fëmijët e lindur nga bashkëjetesa e shtetases M.V. me të ndjerin L.S., i cili ka ndërruar jetë në datën 15.09.2003. I ndjeri ka pasur në pronësi të tij një apartament banimi të ndodhur në rrugën “Don Bosko”, Tiranë, për blerjen e të cilit ka marrë kredi nga një bankë e nivelit të dytë, duke vënë në hipotekë apartamentin në fjalë. Ai ka jetuar në këtë apartament së bashku me vëllezërit e tij deri në vitin 2002, ndërsa në vijim në të kanë banuar subjektet e interesuara Kimete Hoxha dhe Albert Hoxha, përkatësisht emta e të ndjerit dhe djali i saj. Si rrjedhojë e vënies së sekuestros mbi këtë pasuri, për shkak të mosshlyerjes së kredisë bankare, në datën 29.10.2012 subjektet e interesuara kanë paguar në bankë shumën 587.146 lekë, duke shlyer plotësisht kredinë për apartamentin në fjalë.

2. Më pas, përmes kujdestares dhe përfaqësueses ligjore, nënës së tyre, në cilësinë e trashëgimtarëve ligjorë të të ndjerit, kërkuesit u janë drejtuar fillimisht verbalisht subjekteve të interesuara dhe në vijim Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi për lirimin e dorëzimit të apartamentit. Subjektet e interesuara kanë paraqitur kundërpadi, duke kërkuar: i) detyrimin e kërkuesve t’u kthejnë vlerën prej 45.000 USD, paguar të ndjerit për blerjen e apartamentit përmes kontratës së shitblerjes verbale të bërë në marrëveshje me të në një drekë familjare, në prani të vëllezërve të tij; ii) shpërblimin e dëmit, për shkak të vonesës nga viti 2002 deri në ditën e dhënies së vendimit nga gjykata; iii) detyrimin e kërkuesve t’u kthejnë shumën prej 587.146 lekësh dhe kamatat e arrira mbi këtë shumë.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur mospranimin për gjykim të kundërpadisë dhe, në përfundim të shqyrtimit të kërkesëpadisë, me vendimin nr. 10236, datë 24.10.2014, ka vendosur detyrimin e subjekteve të interesuara të lirojnë dhe të dorëzojnë sendin, duke lëshuar po në këtë datë titullin ekzekutiv për vendimin në fjalë. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 1472, datë 16.06.2016, ndërsa me vendimin nr. 00-2024-1043, datë 13.03.2024, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të subjekteve të interesuara. Në vijim, me vendimin nr. 147, datë 27.06.2024, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese ka vendosur moskalimin për shqyrtim në seancë të kërkesës së tyre. Sipas procesverbalit të përmbaruesit gjyqësor privat, të depozituar në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata) nga subjektet e interesuara, rezulton se titulli ekzekutiv është ekzekutuar në datën 17.07.2024, kur ata i kanë dorëzuar apartamentin kërkuesve.

4. Po kështu, në datën 16.07.2014, subjektet e interesuara i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi, me të njëjtin objekt si ai i kundërpadisë fillestare (*shih paragrafin 2 të vendimit*), duke kërkuar njëkohësisht edhe sigurimin e padisë, përmes bllokimit

të kryerjes së veprimeve nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP-ja, Tiranë), Tiranë në lidhje me pronën në fjalë.

5. Në kushtet e mungesës së kontratës noteriale të shitblerjes dhe të marrëdhënieve të zhvilluara në mirëbesim mes familjarësh, bazuar në nenin 235 Kodit të Procedurës Civile (KPC), gjykata ka lejuar marrjen e provës me dëshmitarë, duke pyetur vëllezërit e të ndjerit, të cilët kanë konfirmuar se, në prani të tyre, në një drekë familjare, subjektet e interesuara i kishin paguar të ndjerit shumën 45.000 USD për qëllim të blerjes së apartamentit objekt gjykimi. Ndërsa kërkuesit kanë prapësuar se deklaratimet e dëshmitarëve nuk ishin të vërteta; ekzistenca e veprimit juridik për të cilin ligji kërkonte formë shkresore nuk mund të provohej me dëshmitarë; në periudhën që pretendohet kryerja e pagesës i ndjeri kishte qenë jashtë vendit; e drejta e padisë ishte parashkruar, pasi shuma në fjalë nuk ishte kërkuar brenda afatit 10-vjeçar nga data e dhënies; paditësit provonin pagesën e shumës prej 587.146 lekësh, por jo se ishin pronarë të kësaj shume; kjo pagesë nuk përbënte detyrim të trashëgimlënësit përderisa ishte paguar pas vdekjes së tij; detyrimi ishte i paprovuar dhe nuk rëndonte mbi pasurinë trashëgimore; kërkimi i kamatave ligjore ishte i pambështetur në ligj, pasi nuk kishte pasur ndonjë kërkesë nga paditësit për kthimin e të hollave, që t'i vinte ata në vonesë.

6. Në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. 3257, datë 21.04.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka pranuar pjesërisht kërkesëpadinë, duke detyruar kërkuesit t'u kthejnë subjekteve të interesuara shumat 45.000 USD dhe 587.146 lekë, ndërsa ka rrëzuar kërkesëpadinë për pjesën tjetër. Në të njëjtën datë ajo ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit për vendimin e saj. Në lidhje me çështjen, gjykata ka vënë në dukje se dorëzimi i apartamentit ishte zgjidhur me vendim tjetër të saj, në të cilin kontrata verbale e shitjes së pasurisë ishte çmuar si absolutisht e pavlefshme, për shkak të mungesës së formës noteriale të hartimit të saj; subjektet e interesuara kishin jetuar e vazhdonin të jetonin në këtë banesë prej 10 vjetësh, duke lidhur në emër të tyre kontratat respektive të furnizimit me ujë dhe me energji elektrike; kërkuesit nuk kishin kërkuar më parë kthimin e sendit; përmes provave "dokument" të paraqitura në gjykim subjektet e interesuara kishin provuar shlyerjen e detyrimit të kredisë për apartamentin në fjalë, ndërsa dëshmitë e marra në gjykim provonin pagesën nga subjektet e interesuara të shumës për blerjen e apartamentit. Bazuar në këto prova, gjykata ka arritur në përfundimin se ato vërtetonin marrjen nga i ndjeri të shumës prej 45.000 USD. Ndaj, me qëllim kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme, kërkuesit duhej t'u kthenin subjekteve të interesuara këtë shumë, si përgjegjës për detyrimet e trashëguara nga i ndjeri, si dhe shumën e paguar nga këta të fundit për mbylljen e kredisë dhe ruajtjen e posedimit të pronësisë së sendit. Ndërsa për sa i përket kërkimit për kamatëvonesat, gjykata ka vlerësuar se subjektet e interesuara nuk kishin provuar në gjykim

vonesën në përmbushjen e detyrimit, sipas nenit 481 të Kodit Civil (KC), ndaj ky kërkim duhej rrëzuar. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar ankim kërkuessit dhe subjektet e interesuara.

7. Me vendimin nr. 2423, datë 22.11.2016, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit, duke e gjetur atë të drejtë e të bazuar në ligj me të njëjtin arsyetim. Kërkuessit kanë ushtruar rekurs ndaj këtij vendimi.

8. Me vendimin nr. 00-2025-726, datë 19.02.2025, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se gjykatat më të ulëta kishin vepruar në respektim të normave procedurale dhe materiale, duke bërë cilësim të drejtë të fakteve dhe të rrethanave, si dhe analizë të plotë juridike të provave mbi të cilat kishin zgjidhur mosmarrëveshjen. Po sipas kësaj gjykate, në gjykim kërkuessve u ishte dhënë mundësia të realizonin të drejtën e mbrojtjes, të paraqisnin prova, të njiheshin me provat e palës kundërshtare dhe të debatonin për to, në respektim të së drejtës së tyre për proces të rregullt ligjor.

9. Në datën 09.06.2025 kërkuessit i janë drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, i cili, pas plotësimit sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 14.07.2025. Në vijim, në datën 24.09.2025, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Ndërsa në datat 20.05.2026 dhe 21.05.2026 Mbledhja e Gjyqtarëve ka pranuar kërkesën e dy gjyqtarëve kushtetues për dorëheqjen e tyre nga gjykimi i çështjes.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. **Kërkuessit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se u janë cenuar:

10.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të *standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi: i) arsyetimi i gjykatave se pyetja me dëshmitar është lejuar për të provuar nëse subjektet e interesuara i kishin paguar ose jo të ndjerit shumë prej 45.000 USD është kontradiktor me pjesën që pranon se veprimi juridik i shitjes së pasurisë është i pavlefshëm; ii) gjykatat nuk u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të tyre se sipas nenit 235 të KPC-së dëshmia nuk mund të pranohej, për shkak se dëshmitarët ishin në lidhje familjare dhe në konflikt me ta prej vitesh, dhe se në datën e pretenduar të shitjes së apartamentit i ndjeri ndodhej jashtë vendit. Pasqyrimi formal i argumenteve në vendim dhe mostrajtimi i tyre nga gjykatat u ka cenuar edhe *parimin e kontradiktoritetit*.

10.2. *E drejta e pronës*, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi gjykatat nuk kanë përcaktuar veprimet e të ndjerit nga të cilat rezultonte në mënyrë të padyshimtë qëllimi i tij për shitjen e apartamentit. Lënia e apartamentit në posedim nuk është bërë domosdoshmërisht me qëllimin e shitjes. Gjykatat kanë pranuar ekzistencën e veprimit juridik, kontratës së shitjes së banesës, përmes provës me dëshmitar edhe pse nenet 80 dhe 83 të KC-së kanë përjashtuar këtë lloj prove kur ligji për vlefshmërinë ose të provuarit e një veprimi juridik kërkon formën shkresore. Po kështu, ndonëse subjektet e interesuara nuk kanë provuar veprimin juridik të shitjes së pronësisë së paluajtshme, në kundërshtim me nenet 11, 231 e 235 të KPC-së, gjykatat e kanë pranuar atë si të provuar përmes thënieve të dëshmitarëve, duke qenë kjo prova e vetme mbi të cilën kanë bazuar vendimmarrjet e tyre. Mosreagimi i kërkuësve ndaj veprimeve të subjekteve të interesuara, për të cilat nuk ishin vënë në dijeni, nuk mund të konsiderohet si shprehje e vullnetit të tyre.

11. ***Subjektet e interesuara***, Albert Hoxha dhe Kimete Hoxha, kanë prapësuar se:

11.1. Pretendimet për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* në drejtim të *standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor* janë të pabazuara, pasi gjykatat e zakonshme u kanë dhënë përgjigje të arsyetuara kërkuësve, përfshirë për pretendimin se në datën e pretenduar të shitjes së apartamentit i ndjeri ndodhej jashtë vendit. Po kështu, kërkuësit kanë marrë përgjigje të arsyetuar nga Gjykata e Lartë për disponimet e gjykatave të faktit. Marrja e dëshmimeve në gjykim është bërë në interpretim e në zbatim të drejtë të neneve 233, shkronja “ç”, dhe 235 të KPC-së. Marrëdhënia e posaçme familjare me të ndjerin ka qenë pikërisht shkak se përse veprimi juridik nuk është formalizuar me dokument dhe që i ka çuar ata në lirim e në dorëzimin e apartamentit. Në mungesë të këtij akti, marrja e dëshmimeve ishte e nevojshme për realizimin e një hetimi të plotë e të gjithanshëm të çështjes nga gjykata. Në kundërshtim nga sa kërkuësit pretendojnë, dëshmitë nuk kanë qenë provat e vetme në gjykim, pasi gjykatat kanë marrë e analizuar edhe një sërë aktesh të tjera, të cilat përputheshin me pohimet e palëve në gjykim, të tilla, si: pagesën e bërë prej tyre për likuidimin e kredisë së apartamentit, kontratat e furnizimit me ujë dhe energji që prej vitit 2002 të lidhura në emër të tyre, regjistrimin e tyre në njësinë administrative e vërtetimet e banimit, si dhe aktet përmbare për lirim e dorëzimin e sendit kërkuësve.

11.2. Pretendimet për cenimin e *së drejtës së pronës* janë të pabazuara, pasi në asnjë moment kërkuesit nuk kanë mohuar pagesën e vlerës së apartamentit të ndërjetit ose pagesën e shumës së paguar për likuidimin e kredisë. Marrja e provës me dëshmitar, në zbatim të neneve 233-235 të KPC-së, është pranuar edhe nga jurisprudenca kushtetuese.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesve

12. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

13. Kërkuesit, si individë, legjitimohen *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi kanë qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit kanë ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe kanë interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

14. Për sa i takon kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, ndonëse objekt i ankimit kushtetues individual është vendimi i Gjykatës së Lartë që ka përmbyllur procesin gjyqësor, Gjykata vëren se, në përmbajtje, kërkuesit kanë kundërshtuar edhe vendimet e gjykatave më të ulëta, për të cilat kanë shteruar në formë e në substancë mjetet e zakonshme të ankimit. Ndërsa për procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë ata nuk kanë mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tyre kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

15. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i Ligjit Organik të Gjykatës ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor të paraqitjes së ankimit kushtetues individual nga konstatimi i cenimit. Në prapësimet e tyre subjektet e interesuara kanë parashtruar se, referuar datës së regjistrimit në Gjykatë, ankimi kushtetues individual është

paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor. Po sipas tyre, edhe pse është regjistruar fillimisht si i paplotë, ai nuk është plotësuar nga kërkuesit brenda afatit ligjor 10-ditor të parashikuar nga neni 27, pika 5, i Ligjit Organik të Gjykatës. Fakti që Gjykata ka ripërsëritur kërkesën e saj për plotësimin nga kërkuesit të ankimit kushtetues individual nuk përbën shkak ligjor për legjitimimin *ratione temporis* të tyre.

16. Për sa u takon këtyre pretendimeve, Gjykata evidenton se ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 09.06.2025 dhe është plotësuar në datën 14.07.2025. Gjykata vëren se, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të saj, konsiderohet si datë regjistrimi për efekt të llogaritjes së kriterit *ratione temporis* data e paraqitjes së ankimit kushtetues individual dhe jo data e plotësimit të tij ndaj dhe në referim të faktit se vendimi i Gjykatës së Lartë, që ka përmbyllur procesin gjyqësor të kundërshtuar, mban datën 19.02.2025, çmon se, në kundërshtim nga sa subjektet e interesuara pretendojnë, kërkuesit legjitimohen edhe *ratione temporis*.

17. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, në ankimin kushtetues individual kërkuesit kanë pretenduar se vendimet gjyqësore u kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor (në aspekt të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e kontradiktoritetit), si dhe me të drejtën e pronës, të garantuara respektivisht nga nenet 42 dhe 142, pika 1, dhe 41 të Kushtetutës. Për sa u takon këtyre pretendimeve, Gjykata konstaton se, në thelb, ato parashtrohen në kuadër të qëndrimit të mbajtur nga gjykatat e zakonshme për detyrimin e kërkuesve në kthimin e shumave të paguara nga subjektet e interesuara për apartamentin objekt mosmarrëveshjeje.

18. Duke mbajtur në konsideratë se argumentet mbi të cilat kërkuesit kanë mbështetur pretendimin për cenimin e së drejtës së pronës janë të ndërrvarura me ato për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, bazuar në nenin 42 të Kushtetutës, sipas të cilit prona private nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës private, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë, Gjykata çmon t’i analizojë ato në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e pronës.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e pronës

19. Kërkuesit kanë pretenduar se arsytimi i gjykatave të zakonshme është kontradiktor, pasi, nga njëra anë, pranon marrjen e provës me dëshmitar për vërtetimin e pagesës së shumës 45.000 USD të ndjerit, ndërsa nga ana tjetër konstaton pavlefshmërinë e

veprimit juridik të shitjes së apartamentit. Gjykatat nuk u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të tyre se sipas nenit 235 të KPC-së dëshmia nuk mund të pranohej, për shkak se dëshmitarët ishin në lidhje familjare dhe në konflikt me ta prej vitesh, si dhe në datën e pretenduar të shitjes së apartamentit i ndjeri ndodhej jashtë vendit. Po kështu, pretendimet e kërkuësve janë pasqyruar në vendimmarrjet e kundërshtuara vetëm formalisht.

20. Subjektet e interesuara, Albert Hoxha dhe Kimete Hoxha, i kanë prapësuar si të pabazuara këto pretendime, me argumentin se kërkuësit kanë marrë përgjigje nga gjykatat e faktit për pretendimet e tyre, përfshirë pretendimin se në datën e pretenduar të shitjes së apartamentit i ndjeri ndodhej jashtë vendit. Po sipas tyre, edhe Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje të arsyetuara për disponimet e gjykatave të faktit. Marrja e dëshmive në gjykim është bërë në interpretim e në zbatim të drejtë të dispozitave të KPC-së dhe, në kundërshtim nga sa kërkuësit pretendojnë, dëshmitë nuk kanë qenë prova e vetme në gjykim.

21. Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga neni 42 i Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, i cili përkon edhe me detyrimin e gjykatave për të arsyetuar vendimet, sipas nenit 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i drejtësisë së vendimeve. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 38, datë 19.03.2026; nr. 11, datë 10.03.2023; nr. 16, datë 16.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Po sipas Gjykatës, vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiktë të hapur ose të fshehtë. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Argumentet duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe për të pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 10, datë 11.02.2026; nr. 16, datë 16.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Për sa i përket së drejtës për pronë private, të parashikuar nga neni 41 i Kushtetutës, Gjykata ka theksuar se ajo përbën një ndër aspektet më thelbësore të shoqërisë demokratike. Sipas Gjykatës, si e drejtë universale e njeriut, e drejta e pronës përfshin çdo posedim të sendeve ose të të drejtave të tjera materiale pasurore dhe në një shtet demokratik individit duhet t'i garantohet gëzimi i qetë dhe pa pengesa të paarsyeshme i kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 32, datë 19.05.2025; nr. 31, datë 18.04.2024; nr. 36, datë 21.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, edhe detyrimet monetare që sigurojnë shlyerjen e kredisë bankare e mjeteve

garantuese të saj përfshihen në konceptin kushtetues të pronës (*shih vendimin nr. 24, datë 04.03.2026 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Duke mbajtur në konsideratë standardet e mësipërme kushtetuese, Gjykata do të vlerësojë në vijim nëse gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë marrë në shqyrtim dhe kanë analizuar pretendimet e kërkuësve, duke mbajtur qëndrim të shprehur për to. Në këtë kuadër, Gjykata do të verifikojë edhe nëse vendimmarrjet gjyqësore kanë identifikuar dhe kanë pasqyruar qartë faktet e çështjes e dispozitat ligjore të zbatueshme dhe nëse gjykatat kanë dhënë argumente të mjaftueshme për të mbështetur përfundimet e arritura për zgjidhjen e saj. Po kështu, do të analizohet nëse arsyetimi i vendimeve paraqet kundërtënie ose kontradikta të tilla që cenojnë standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

24. Gjykata rithekson se nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku janë bazuar gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për zgjidhjen e çështjes së themelit, çka mbetet detyrë funksionale e atyre gjykatave. Në aspektin e kontrollit kushtetues, ajo verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 48, datë 22.09.2025; nr. 31, datë 29.05.2023; nr. 2, datë 11.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në rastin konkret, Gjykata vëren se, në situatën kur me vendim gjyqësor të ekzekutueshëm është vendosur detyrimi i subjekteve të interesuara për dorëzimin e apartamentit kërkuësve (*shih paragrafin 3 të këtij vendimi*), këto subjekte kanë paraqitur kërkesëpadi, duke kërkuar detyrimin e kërkuësve t'u kthejnë shumën që i kishin paguar familjarit të tyre të ndjerë për blerjen e apartamentit, si dhe shumën që kishin paguar për qëllime të shlyerjes së kontratës së huas bankare të marrë nga i ndjeri për apartamentin në fjalë dhe kamatës përkatëse për këtë shumë.

26. Nisur nga faktet që pagesa për shlyerjen e detyrimit të kredisë vërtetohej përmes provës dokument të lëshuar nga banka e nivelit të dytë, ndërsa shitja e apartamentit nuk ishte kryer me akt noterial, por sipas subjekteve të interesuara pagesa për blerjen e tij ishte bërë në mirëbesim, bazuar në nenin 235 të KPC-së që, si rast përjashtimor, lejon marrjen e dëshmisë së familjarëve, për qëllime të përcaktimit të fakteve dhe të rrethanave për pagesën e shumës 45.000 USD, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka marrë në pyetje vëllezërit e të ndjerit, të cilët kanë pohuar qëndrimin e subjekteve të interesuara (*shih paragrafin 5 të këtij vendimi*). Kërkuësit i kanë prapësuar si të pabazuara këto dëshmi, me argumentet se ekzistenca e një veprimi juridik, për të cilin ligji kërkonte formë shkresore, nuk mund të provohej me dëshmitar dhe se i ndjeri kishte qenë jashtë vendit në periudhën kur pretendohet realizimi i shitjes së banesës.

27. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Gjykata i ka rrëzuar si të pabazuara prapësimet e kërkuësve, me arsyetimin se pyetja si dëshmitarë e vëllezërve të të ndjerit kishte qenë e nevojshme për të provuar nëse shuma 45.000 USD, pasuri kjo e luajtshme, i ishte dhënë ose jo të ndjerit dhe jo për qëllime të kryerjes ose jo të veprimit juridik të shitjes së pasurisë së paluajtshme, për të cilën neni 83 i KC-së kërkonte formën shkresore. Po kështu, në kundërshtim nga sa kërkuësit pretendonin, asnjëri prej dëshmitarëve nuk kishte deklaruar në mënyrë të saktë datën kur ishte realizuar dhënia e shumës së parave. Sipas gjykatës, bazuar në provat e depozituara në gjykim, nga të cilat rezultonte se sendi ishte poseduar për shumë vite nga subjektet e interesuara dhe kërkuësit nuk kishin kërkuar lirimin e pronës e nuk kishin ndërmarrë veprime për pagesën e detyrimeve të kredisë gjatë kësaj periudhe, si dhe duke mbajtur në konsideratë se tashmë kishte një vendim tjetër gjyqësor të saj për dorëzimin e apartamentit, palët duhej të ktheheshin në gjendjen e mëparshme, duke kthyer çdo gjë që i kishin marrë e dhënë njëra-tjetrës. Ndërsa kërkimi i subjekteve të interesuara për kamatëvonesat duhej rrëzuar, për sa kohë që ekzekutimi i këtij detyrimi nuk ishte kërkuar.

28. Vendimi i gjykatës së rrethit është vlerësuar i drejtë dhe i bazuar në ligj nga Gjykata e Apelit Tiranë me të njëjtin arsyetim, ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka konkluduar se gjykatat më të ulëta kishin vepruar në respektim të normave procedurale dhe materiale, duke bërë cilësim të drejtë të fakteve dhe të rrethanave për mosmarrëveshjen dhe analizë të plotë juridike të provave, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Sipas këtij kolegji, interpretimi që gjykata e rrethit dhe ajo e apelit i kishin bërë nenit 233 të KPC-së për marrjen dhe vlerësimin e provave me dëshmitar ishte i drejtë, ndërsa në kuptim të neneve 106 e 674 të KC-së, pavlefshmëria e veprimit juridik nuk mund të përbënte rrethanë për përfitimin pa të drejtë nga kërkuësit të shumës së çmimit që paditësit kishin paguar në mirëbesim për qëllime të realizimit të veprimit juridik. Po kështu, në gjykim kërkuësve u ishte dhënë mundësia të realizonin të drejtën e mbrojtjes, të paraqisnin prova, të njiheshin me provat e palës kundërshtare dhe të debatonin për to, në respektim të së drejtës së tyre për proces të rregullt ligjor.

29. Në analizë të vendimmarrjeve të gjykatave të zakonshme, Gjykata vëren se gjykatat e faktit kanë marrë në shqyrtim e analizuar pretendimet e kërkuësve, si për sa i përket marrjes së provës me dëshmitar, ashtu edhe vendndodhjes të të ndjerit në datën e pretenduar të shitjes së apartamentit. Duke pasur në konsideratë procesin gjyqësor për kthimin e sendit, në analizë të fakteve e të rrethanave të çështjes, si dhe dispozitave ligjore të zbatueshme, ato kanë mbajtur qëndrim të shprehur për shkaqet që i kanë çuar në rrëzimin e pretendimeve të kërkuësve, duke dhënë argumente të mjaftueshme në mbështetje të konkluzioneve të tyre. Në kundërshtim nga sa kërkuësit pretendojnë, vendimmarrjet e këtyre gjykatave nuk janë mbështetur vetëm në

dëshmitë e vëllezërve të të ndjerit, por edhe në një sërë provash të tjera të paraqitura në gjykim nga palët (*shih paragrafin 6 të vendimit*). Cilësimi i rrethanave të mosmarrëveshjes e identifikimi dhe interpretimi i ligjit procedural e material nga këto gjykata i janë nënshtruar më pas kontrollit të ligjshmërisë nga Gjykata e Lartë, e cila, në përputhje me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, u ka dhënë përgjigje të arsyetuara pretendimeve të ngritura nga kërkuesit në rekurs.

30. Gjykata vëren gjithashtu se vendimet e mësipërme përmbajnë të dhënat e palëve, shkaqet e parashtruara në ankim dhe në rekurs, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese mbi të cilën është mbështetur qëndrimi i shprehur në dispozitiv. Ato nuk rezultojnë të jenë arbitrare, alogjike, kontradiktore ose të paqarta në përmbajtjen dhe vlerësimin e tyre. Për rrjedhojë, vlerëson se pretendimet e kërkuesve për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor janë të pabazuara, ndaj, në këtë kontekst, vendimet e kundërshtuara nuk rezultojnë as në cenim të së drejtës së tyre për pronën.

31. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesve janë të pabazuara, sipas arsyetimit të mësipërm, ndaj kërkesa rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 26.05.2026

Shpallur më 03.07.2026